

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M


Nr. 07, datë 21.02.2020

**Për miratimin e Raportit për aktivitetin investues të
Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme
për vitin 2019**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 71 pika 2, të nenit 73, pikat 1, 2 dhe 3, dhe të nenit 79, pika 5 të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 18, pika 1 të Vendimit nr. 56, datë 3.10.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e Rregullores “Për fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, të nenit 6, pika 2, shkronja “g” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31/10/2018, të nenit 8, pika 3, shkronja “j” të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të miratojë Raportin për aktivitetin investues të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin 2019, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për dërgimin e këtij vendimi dhe të raportit në Bankën e Shqipërisë.



KËSHILLI DREJTUES

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Sektori i Financës dhe Investimeve, si dhe Sektori i Analizës së Riskut.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar